



Nr. prot. 95, Datë 04.02. 2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

“Halimi Foundation Institute”

- dhe -

“Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti, “Albanian University”

Datë 04/02 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE

- Neni 1 – Deklarimet Paraprake
- Neni 2 – Objekti i Marrëveshjes
- Neni 3 – Rregullorja e Konkursit
- Neni 4 – Modalitetet e afatit dhe marrëveshjes
- Neni 5 – Të drejtat dhe detyrimet e Fakultetit
- Neni 6 – Të drejtat dhe detyrimet e Halimi Foundation Institute
- Neni 7 – Konfidencialiteti
- Neni 8 – Përfundimi i Marrëveshjes
- Neni 9 – Njoftimet
- Neni 10 – Forca madhore
- Neni 11 – Ligji përkatës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve
- Neni 12 – Dispozitat e përgjithshme

Kjo Marrëveshje është nënshkruar më datë 04/02/2022 (data e hyrjes në fuqi) ndërmjet palëve:

- “**Halimi Foundation Institute**”, një organizatë jo qeveritare, jo fitimprurëse, e themeluar me vendimin Nr. 843 datë 01.06.2021 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në “Bulevardi ‘Dëshmorët e Kombit’”, Kulla 2, Kati: 13, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Arlind Ahmetaj në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, (këtu e në vijim referuar si “**Halimi Foundation Institute**”,)

-dhe-

- “**Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti, “Albanian University”** person juridik me seli në adresën: “Bulevardi Zogu I”, Tirana, Shqipëri, e-mail: k.naska@albanianuniversity.edu.al, përfaqësuar nga Dekani, Prof. Dr. Kaliopi Naska (këtu e në vijim referuar si “FAKULTETI”)

Në vijim secila do të referohet veçmas si "Palë" dhe bashkërisht si "Palët".

Neni 1 **Deklarimet paraprake**

- “**Fakulteti**” është një institucion privat i arsimit të lartë që synon t’iu ofrojë studentëve të saj njohuri teorike dhe praktike të dobishme për t’u aplikuar në tregun e punës.
- “**Halimi Foundation Institute**” është një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse që ka si qëllim të mbështetjen e juristëve të rinj, të studentëve të ekselencës në drejtësi, brenda dhe jashtë vendit, promovimi i elitës se re në fushën e drejtësisë organizimi i eventeve dhe fundrasing në funksion të qëllimit kryesor të fondacionit, etj;
- Në përputhje me qëllimet, funksionet e tyre dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, palët bien dakord për të nënshkruar këtë marrëveshje bashkëpunimi, për sa parashikohet në vijim.

Neni 2 **Objekti i Marrëveshjes**

- “Fakulteti” dhe “**Halimi Foundation Institute**” bien dakord që të bashkëpunojnë në realizimin e projektit “University Law Competition”, i cili do të ketë në fokus organizimin e një gjyqi simulues, ku studentë, përfaqësues të universiteteve shqiptare dhe jo vetëm, do të kenë mundësinë e zbatimit të njohurive teorike të grumbulluara gjatë viteve të studimit.

Neni 3 **Rregullorja e Konkursit**

- Palët njojin dhe zbatojnë të gjitha rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Konkursit.

- “Halimi Foudantion Institute” ka të drejtë të bëjë ndryshime në rregulloren e përcaktuar, të cilat duhet t’ua komunikojë pjesëmarrësve deri në 10 ditë para fillimit të konkursit.
- Një kopje e Rregullores së Konkursit i është bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 **Modalitetet e afatit dhe i marrëveshjes**

- Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj.
- Kjo marrëveshje lidhet për një afat 1 vjecar.
- Në çdo kohë, para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së marrëveshjes, palët mund të kërkojnë zgjatjen ose ndryshimin e afatit nëpërmjet një marrëveshjeje të re me shkrim.
- Çdo ndryshim në këtë marrëveshje është i vlefshëm dhe mund të konsiderohet pjesë përbërëse e saj vetëm nëse është në formë të shkruar, rënë dakord dhe nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 5 **Të drejtat dhe detyrimet e “Fakultetit”**

- Fakulteti ka të drejtë dhe detyrim të formojë një skuadër (përfaqësues) të përbërë nga 5 anëtarë, siç specifikohet në rregulloren e konkursit.
- Fakulteti ka të drejtë, të trajnoi, përgatisë, skuadrën e saj pjesëmarrëse për përfaqësimin dinjitoz të Fakultetit/Universitetit në këtë konkurs.
- Fakulteti ka të drejtë të kërkojë informacion për çdo ndryshim të mundshëm të Rregullores së Konkursit.
- Fakulteti ka të drejtë të kërkojë informacion lidhur me Fakultetet/Universitetet pjesëmarrëse në këtë konkurs, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshje.
- Fakulteti ka të drejtë dhe detyrim të veprojë në përputhje me parashikimet e kësaj marrëveshje, deri në realizimin e qëllimit të saj.

Neni 6 **Të drejtat dhe detyrimet e “Halimi Foundation Insitute”**

- Halimi Foundation Insitute ka detyrimin të mbikëqyrë zhvillimin e konkursit nëpërmjet personave të autorizuar nga ai, deri në përfundim të kohëzgjatjes së saj.

- Halimi Foundation Institute ka të drejtë të kërkojë informacion referuar identitetit të përfaqësuesve të Fakultetit/Universitetit (pedagogë dhe student) që do të marrin pjesë në konkurs.
- Halimi Foundation Institute merr përsipër të angazhohet për promovimin e “University Law Competition”, pjesëmarrësit të saj etj., në kuadër të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 7 Konfidencialiteti

- Sipas kësaj marrëveshjeje “**Informacion Konfidencial**” do të nënkuptojë produktin e punës dhe çdo informacion në lidhje me realizimin e projektin, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kërkimin, zhvillimet, planet, shërbimet, formulat, proceset, teknikat, udhëzues, ide, zbulime, përmirësimi, të drejtat e autorit, informacionet mbi sponsorët, financat, për të cilat Fakulteti është informuar drejtpërdrejt ose tërthorazi me shkrim ose verbalisht nga Halimi Foundation Institute.
- Përveç nëse është rënë dakord ndryshe paraprakisht dhe me shkrim, palët nuk do të përdorin informacionin konfidencial për ndonjë qëllim tjeter nga ai i përcaktuar në këtë marrëveshje ose t'ia zbulojë informacionin konfidencial ndonjë pale të tretë, përveç rasteve kur kërcohët nga ligji ose vendimi i një gjykate.

Neni 8 Përfundimi i Marrëveshjes

- Marrëveshja do të konsiderohet e përfunduar kur ka përfunduar afati i kohëzgjatjes së saj sipas parashikimeve të nenit 3 (Modalitetet e afatit dhe formës së marrëveshjes) të kësaj marrëveshjeje.
- Palët mund të kërkojnë zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje përpala përfundimit të kohëzgjatjes së saj, në rastin e mosmarrëveshjeve apo për çdo shkak tjeter, duke njofuar paraprakisht me shkrim të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë para, sipas mënyrave të kontaktit të përcaktuar tek nisi 10 (Njofimet) i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9 Njofimet

- Njofimet dhe çdo komunikim tjeter ndërmjet palëve bëhet nëpërmjet adresave elektronike apo postare dhe përfaqësuesve të tyre si më poshtë:
 - Kontaktet e Halimi Foundation Institute :**
Z. Arben Brace
Drejtor Ekzekutiv
Halimi Foundation Institute
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 13
Tiranë, Shqipëri
Cel: +355 69 20 45 568;
E-mail: _____ @ _____

Alban Avdulla

Drejtor Projektit
Halimi Foundation Institute
Bvl. "Deshmoret e Kombit", Kull.Binjake, Kulla 2, Kati 13,Tirana, Albania.
Email: aavdulla@halimi.al;
Cel: +355 69 53 00 890;

- b. **Kontaktet e Fakultetit:**
Ph.D. Doriana PANO
Adresë: "Bulevardi Zogu I", Tirana, Shqipëri.
Cel: **tel: +355 672058585**
E-mail: dorjanapano@yahoo.com / d.pano@albanianuniversity.edu.al
- Për çdo ndryshim të adresës, palët do të njoftojnë me shkrim të paktën dhjetë (10) ditë përpara.
- Forca Madhore**
- Secila palë do të shfajësohet nga çdo vonesë ose dështim në përbushjen e detyrimeve të tyre, nëse shkaku lidhet me ndodhi jashtë kontrollit të saj të arsyeshëm, duke përfshirë, por pa u kufizuar në veprat e natyrës, e luftës, zjarrit, kryengritjes, grevave, bllokime ose mosmarrëveshje të tjera serioze të punës, trazira, shpërthime,
 - Detyrimet dhe të drejtat e palës së shfajësuar në këtë mënyrë do të zgjaten çdo ditë për periudhën kohore të barabartë me periudhën e një ndërprerjeje të tillë të falshme. Kur ngjarje të tilla të janë zvogëluar, detyrimet përkatëse të palëve sipas këtij ligji do të rifillojnë.
 - Në rast se ndërprerja e detyrimeve të palës së shfajësuar vazhdon për një periudhë më të madhe se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike, secila palë do të ketë të drejtë të ndërpresë këtë marrëveshje me njoftimin me shkrim 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para palës tjetër.

Neni 11 Ligji përkatës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje e lindur mes tyre, në kuadër të këtij bashkëpunimi do të zgjidhet me pajtim/negociata mes palëve. Nëse palët nuk do të janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen në fjalë brenda një afati kohor të arsyeshëm, atëherë ato mund ti drejtohen gjykatës kompetente, të caktuar me ligj, për zgjidhjen e çështjes në fjalë.
- Kjo marrëveshje do të udhëhiqet dhe do të interpretohet në përputhje me legjisacionin e Republikës së Shqipërisë.
- Palët bien dakord paraprakisht se kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 12 Dispozitat e përgjithshme

- Kjo marrëveshje rregullon marrëdhënien juridike të lindur mes palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo bisedimet e mëparshme. Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet përvçese me shkrim të nënshkruar nga përfaqësues të autorizuar të palëve.
- Nëse ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje do të konsiderohet, nga një gjykatë e kompetente si e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, kjo do të vlejë vetëm për atë dispozitë konkrete duke mos cenuar vlefshmérinë e dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje ose tërësisë së saj. Të gjitha kushtet e tjera të kësaj marrëveshjeje do të mbeten në fuqi, do të kenë efekt të plotë dhe do të interpretohen në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Palët deklarojnë se janë njojur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje dhe nga data e nënshkrimit të saj detyrohen të veprojnë në përputhje me parashikimet e saj.
- Palët marrin përsipër që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën gjatë gjithë kohëzgjatjes, të përcaktuar në nenin 3, në mirëbesim dhe të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin e kësaj marrëveshje dhe realizimin e qëllimit të saj.

Kjo marrëveshje është hartuar në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, 1 (një) kopje për secilën palë. Çdo kopje ka të njëjtën përbajtje dbe të njëjtën vlerë ligjore.

PALËT:

Për dhe në emër të
“Halimi Foundation Institute”

Përfaqësuar nga,
 Drejtori Ekzekutiv
 Z. Arben Brace



Për dhe në emër të
**“Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti,
 “Albanian University”**

Përfaqësuar nga,
 Dekani
 Prof. Dr. Kaliopi Naska

